

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Nr. 511 Prot

Vlorë më 31 . 01 . 2025



NASTO INXHINIERING VLORE

Nr. 036/25 Prot

Vlorë më 06 . 02 . 2025

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

NDERMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

DHE

NASTO INXHINIERING VLORE

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, institucion i arsimit të lartë publik, përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj, Rektor i Universitetit.

Dhe

Nasto Inxhiniering Vlorë, përfaqësuar nga Administrator Lendi NASTO

Nisur nga interesi i përbashkët, për zhvillimin e aktiviteteve me karakter arsimor, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm si dhe me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin tonë palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (si më poshtë):

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 4, gërma c).

Neni 2 Qëllimi dhe mënyra e bashkëpunimit

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe NASTO INXHINIERING VLORE, duke përfshirë:

- Bashkëpunimin e pedagogëve të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Stafit të NASTO INXHINIERING VLORE, si dhe studentëve për realizimin e detyrave të kursit, projekteve dhe kërkimit shkencor në fushat e Inxhinierive mekanike, navale dhe elektrike.
- Vënien në dispozicion të personelit të NASTO INXHINIERING VLORE për mësimdhënie në modulet e programeve mësimore të FSHTN.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, ëorkshop-e).
- Realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale të programeve të fushës së Inxhinierisë dhe Teknologjisë Detare, të ofruara nga FSHTN.
-

Neni 3 Sfera e bashkëpunimit

Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti "Ismail Qemali"

Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në dy cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor
- Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master (profesional dhe shkencor)

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara.
- Praktikat mësimore
- Praktikat profesionale
- Projektet kërkimore

Neni 4

Detyrimet e palëve

Secila palë e Marrëveshjes do të caktojë një person kontakti për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

Personeli i Shkencave Teknike dhe Natyrore, studentët e programeve mësimore të FSHTN si dhe personeli i NASTO INXHINIERING VLORE janë të detyruar të zbatojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje, për të cilat është rënë dakort nga titullarët e të dy institucioneve.

Amendamente të mundshme ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.

Neni 5

Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjes të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive Madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 6

Përdorimi i të dhënave

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Nasto Inxhiniering Vlorë kanë detyrimin në mbrojtjen e të dhënave konform ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe ruajtjen dhe mospërdorimin e informacioneve e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7
Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit
2. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 8
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet përmes mirëkuptimit dhe negociatave mes Palëve.

Neni 9
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në dy 4(katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit Vlorë dhe Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, 2(dy) kopje do të depozitohet në NASTO INXHINIERING VLORE.

PËR
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI"
VLORE

REKTORE
PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR
NASTO INXHINIERING VLORE

ADMINISTRATOR
Z. LENDI NASTO

